

VENDIM
Nr. 61, datë 6.6.2013

**PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “TEODORI 2003” SHPK, PËR LËNIEN
PENG TË ASETEVE TË SAJ SI KOLATERAL PRANË BANKAVE “BERZH” DHE “SOCIETE
GENERAL ALBANIA”**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 20 pika “1” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 10 pika 1 dhe 11 të rregullores “Për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin nr. 89, datë 13.12.2006 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, pikave 1.3 dhe 1.6 të licencës me seri PV10P “Për prodhimin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.6.2013, pasi shqyrtoi kërkesën për lënien peng të aseteve si kolateral nga shoqëria “Teodori 2003” sh.p.k., pranë Bankave “BERZH” dhe “Societe General Albania”, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Teodori 2003” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1.1 dhe 1.2, emri dhe adresa e plote e të licencuarit. (Janë paraqitur në mënyrë të plotë dhe korekte.)

- Neni 7, pikat 1.3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, përshkrimi i të licencuarit dhe informacioni lidhur me aktivitetin e tij. (Ky informacion është dhënë i plotë me të gjitha detajet e kërkuara nga rregullorja.)

- Neni 7, pikat 2, 3, 4 dhe 5 (ky informacion është plotësuar tërësisht.)

Është paraqitur lista e aseteve për t’u lënë peng si kolateral.

Për gjithë sa më sipërcituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë “Teodori 2003” sh.p.k., për lënie peng si kolateral të aseteve të saj pranë bankave “BERZH” dhe “Societe General Albania”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani